

Udhëzues
për Projektin

kursori

Si edukimi i hapur online
ndihmoi të rinjtë nga Kosova
dhe Shqipëria të zhvillojnë
aftësitë e tyre programuese.



Financuar nga:



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Albania - Kosovo

IPA Cross Border Cooperation Programme

Zbatuar nga



OPEN DATA KOSOVO

ALBANIAN INSTITUTE
of SCIENCE



kursori

Edukim i Hapur TIK
për Punësimin e të Rinjëve

Kursori.org është platformë e edukimit të hapur online, ku përmban tri kurse në fushën e TIK në gjuhën shqipe. Kjo platformë është krijuar për qëllim që të zgjerojë aftësitë teknike tek të rinjtë, të adaptojë të rinjtë me teknologjitë e reja në treg, të rris zhvillimin e karrierës, aftësitë e ndërmarrësisë dhe të lehtësojë punësimin.

1. Përmbajtja

1. Rëndësia dhe Historiku i Edukimit Online	4
2. Edukim i Hapur TIK për Punësimin e të Rinjëve	6
3. Open Data Kosovo (ODK) / Çfarë bëjmë ne?	10
4. Albanian Institute of Science (AIS) / Çfarë bëjmë ne?	11
5. Si të arrijmë bashkëpunime me institucionet arsimore në Kosovë dhe Shqipëri?	12
6. Kursori dhe Rrugëtimi i tij	14
7. Programi i financuar nga BE-ja	17
8. Rekomandimet nga përfituesit	18

1. Rëndësia dhe Historiku i Edukimit Online

Kur flasim për edukimin online, organizata Open Data Kosovo së bashku me organizatën partnere nga Shqipëria, Instituti Shqiptar i Shkencave - AIS kanë përdorur të mirat e edukimit online si mjet për të edukuar studentët dhe nxënësit duke shfrytëzuar të mirën e teknologjisë, informacionit dhe të komunikimit.

Edukimi online është i përshtatshëm për njerëzit që kanë detyrime familjare dhe që kanë vështirësi në ndjekjen e një klase të rregullt. Gjithashtu, për studentët që nuk kanë mundësi të vijojnë klasët tradicionale të të mësuarit.

Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor është bërë i domosdoshëm. Teknologjia ka fuqinë dhe potencialin për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënies. Ajo ndikon mësimdhënien e suksesshme dhe u krijon mundësi nxënësve për të mësuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve e

përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta.

Ky zhvillim është lidhur më së miri në këtë nismë nga Open Data Kosovo dhe Instituti Shqiptar i Shkencave duke përdorur një paradigmë të re të arsimit - MOOC (Massive Open Online Courses). Në këtë skenar MOOC, një dimension i ri i mundësive arsimore bashkon instruktorët dhe studentët në të gjithë botën më afër përmes mediumit virtual të internetit. Institucionet, instruktorët dhe studentët janë në gjendje të bashkëpunojnë mes njëri-tjetrit globalisht.

Duke përdorur të mirat e MOOC (Massive Open Online Courses) Open Data Kosovo dhe Instituti Shqiptar i Shkencave ka krijuar platformën Kursori.org duke përdorur kornizën e edX.

(1) MOOC krijon mundësinë për shkëmbimin e ideve dhe njohurive dhe gjithashtu ndihmon në përmirësimin e aftësive të të mësuarit duke siguruar qasje të lehtë në burimet globale.

(2) Përmirëson marrëdhëniet ndërkulturore, të cilat çojnë në bashkëpunim midis arsimtarëve të institucioneve dhe nxënësve në vend dhe në nivelin ndërkombëtar.

(3) MOOC rrit të mësuarit aktiv. Hulumtimet tregojnë se studentët mësojnë më shumë përmes të mësuarit aktiv (kur ata kanë detyra ose diskutim për një çështje) dhe jo përmes dëgjimit të ligjëratave. Studentët i dëgjojnë ligjëratat më me vëmendje nëse u është dhënë një problem ose detyrë për të zgjidhur para ligjëratave. Në këtë drejtim, struktura që kanë shumica e MOOC - leksione të shkurtra, të alternuara me detyra dhe kuize - duket se është ideale. Sigurisht, mund të bëhet një gjë e tillë edhe në një klasë, por do të ishte më e vështirë të sigurohej që të gjithë studentët të marrin pjesë: disa mund të kenë nevojë më të gjatë për të asimiluar përmbajtjen e leksionit, dhe preferojnë ta dëgjojnë përsëri para se të kryejnë detyrën. Kontakti nga bashkëmoshatarët, i lehtësuar nga MOOC, gjithashtu mund të shkaktojë një mësim efektiv aktiv.



2. Edukim i Hapur TIK për Punësimin e të Rinjëve

Edukim i Hapur TIK për Punësimin e të Rinjëve është Projekt ndërkuftar i zbatuar nga dy organizata partnere nga Kosova (rrjedhimisht Open Data Kosovo - ODK dhe nga Shqipëria (rrjedhimisht Instituti Shqiptar i Shkencave - AIS). Projekti është financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri përmes programit ndërkuftar IPA - Shqipëri dhe Kosovë.

Projekti me kohëzgjatje 27 muaj (15 Shkurt 2018 - 15 Prill 2020) ka për qëllim përmirësimin e mundësive për punësimin e të rinjëve nga Kosova dhe Shqipëria duke ofruar qasje të hapur në njohuri dhe aftësi shumë të rëndësishme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Më konkretisht, ky projekt krijon një mundësi të të mësuarit për të rinjtë e dy Bashkive, Lezhë dhe Kurbin në Shqipëri dhe 2 komunave, Pejë dhe Prizren në Kosovë.

Në kuadër të këtij projekti është zhvilluar platforma Kursori.org, ku kjo platformë ofron 3 kurse në fushën e TIK dhe këto kurse janë të qasshme online dhe në gjuhën shqipe.

– Pse TIK?

Fusha e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është fushë shumë e kërkuar dhe në zhvillim si në nivelin global, po ashtu edhe në nivelin shtetëror (Kosovë dhe Shqipëri). Në Kosovë, fusha e TIK ka përjetuar një zhvillim të hovshëm përgjatë viteve, e sidomos pas vitit 1999.

Vetëm në 10 vitet e fundit ka pasur rritje në biznese që operojnë në fushën e TIK për 187%, e dhënë kjo e nxjerrë nga Platforma The Future Workplace (www.thefutureworkplace.org/). Mirëpo, përpos bizneseve që janë hapur në fushën e TIK, ka pasur rritje edhe në shkollimin dhe edukimin rreth kësaj fushe specifike.

Në 5 vitet e fundit në Kosovë, ka pasur rritje prej 49% të të diplomuarve në Universitete me kurrikula të mbështetura në fushën e TIK. Mirëpo, përpos zhvillimit të bizneseve dhe Universiteteve që operojnë në këtë fushë, hendeku i tregut të punës ishte ende prezent. Për arsye që zhvillimi i fushës së TIK morri hov të madh, kurrikulat e institucioneve edukative/arsimore nuk arritën të përditësohen plotësisht që të jenë në një linjë me zhvillimin e fushës në nivelin global. Prandaj, edhe hendeku i aftësive të fushës së TIK u paraqit si problem në Kosovë dhe Shqipëri.

Duke konsideruar kështu arsyet e lartpërmendura, dhe analizat e ndryshme që u krijuan në kuadër të Projektit, u pa e rëndësishme të propozohet një ide rreth kësaj fushe specifike.



– Qëllimet dhe Objektivat e Projektit

Edukim i Hapur TIK për Punësimin e të Rinjëve' u ndërtua mbi një objektivë kryesore dhe disa objektiva dytësore.

Objektivi kryesor i Projektit paraqitet si në vijim:

1. Nxitja e punësimit të të rinjve duke siguruar një qasje të hapur ndaj njohurive dhe aftësive kritike, dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkuftar midis qendrave të specializuara të njohurive.

Objektivat dytësore të Projektit paraqiten si në vijim:

1. Ofrimi i njohurive kritike të TIK për nxënësit e shkollave të mesme, shkollave profesionale dhe studentët e universiteteve përmes platformës rajonale të edukimit të hapur (MOOC);
2. Fuqizimi i të rinjëve të gjejnë punë, të fillojnë një nismë sipërmarrëse dhe/ose të ndjekin studime të mëtutjeshme në fushën e TIK duke i mbështetur ata në përdorimin aktiv të njohurive të fituara rishtazi;
3. Mbështetja e qendrave rajonale të të mësuarit (Universitete, shkolla të mesme, shkolla profesionale) në rritjen e zbatueshmërisë praktike të mësimit të tyre për nevojat e tregut të punës dhe krijimin e një rrjeti të entuziastëve, mësuesve dhe pionierëve të rajonit.



Disa nga treguesit kryesor dhe rezultatet e dizajnuara të Projektit janë:

1. 10 % të studentëve/nxënësve të cilët kanë përfunduar tri kurset do të punojnë në fushën e TIK (punojnë për dikë ose të vetëpunësuar) 6 muaj pas përfundimit të kurseve;
2. 10% të studentëve/nxënësve të cilët kanë përfunduar tri kurset do vazhdojnë edukimin e lartë në fushën e TIK një vit pas përfundimit të kurseve;
3. 10 zgjidhje dixhitale/prototipe për përdorim personal ose biznesor do të zhvillohen;
4. 500 nxënës/student do të regjistrohen në platformën Kursori;
5. 400 nxënës/student do të përfundojnë të tri kurset në platformën Kursori;
6. 7 Qendra të specializuara të të mësuarit (shkolla të mesme, shkolla profesionale, Universitete) do inkuadrojnë aftësitë e marra nga kurset online në mësimdhënie të rregullt;
7. 2 aktivitete bashkëpunimi të zhvilluara mes qendrave të specializuara të të mësuarit në Kosovë dhe Shqipëri me qëllim që të nxisin punësimin tek të rinjtë në fushën e TIK do të zhvillohen.

Në përgjithësi, treguesit e Projektit prezantojnë njëkohësisht edhe rezultatet të cilat do të shihen pas përfundimit të Projektit.

3. Open Data Kosovo (ODK) / Çfarë bëjmë ne?

Open Data Kosovo (ODK) dizajnon, zhvillon dhe krijon zgjidhje digjitale për një portfolio të gjerë të partnerëve, ndër të cilët janë edhe institucionet publike të Kosovës. Ekspertiza e organizatës në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, bën pajisjen e partnerëve me mjete dhe njohuri që mbështesin vendimmarrjen, politikë-bërjen me të dhëna në strategji ditore.

Të gjitha projektet e zhvilluara nga ODK në Kosovë kanë për bazë rritjen e transparencës në proceset qeverisëse, duke hapur të dhënat e qeverisë dhe duke hedhur dritë mbi punët e brendshme të aktiviteteve qeveritare (p.sh. hapja e të dhënave të prokurimit për të dokumentuar dhe monitoruar më mirë praktikën e prokurimit).

Jashtë Kosovës, ODK udhëheqë dhe bashkëpunon në iniciativë të ndryshme të cilat promovojnë praktikën më të mirë të të dhënave të hapura, ndër të cilat Open Contracting Data Standards. ODK poashtu ka marrë mirënjohje ndërkombëtare për zhvillimin e një algoritmi red-

flag i cili në mënyrë automatike analizon të Dhënat e Hapura të prokurimit në Kosovë dhe thekson parregullsitë e mundshme në përdorimin e parave publike. Shtylla tjetër mbi të cilën ODK vepron është fuqizimi i të rinjëve, ngritja e pjesëmarrjes së të rinjëve në vendimmarrje, dhe zvogëlimi i hendekut të aftësive të TIK në Kosovë dhe rajon, e gjitha kjo duke zhvilluar aftësitë teknike tek të rinjtë.

E fundit jo më pak e rëndësishme për herë të parë në Ballkanin Perëndimor ODK ka qenë finaliste dhe është njohur në revistën prestigjioze Forbes 30 Under 30 në kategorinë Law and Public Policy ku falë implementimit të suksesshëm të projekteve të ndryshme me qëllim të hapjes institucionale dhe ofrimit të transparencës dhe llogaridhënjes për shoqërinë Kosovare, u njoh me një revististë të tillë. Rëndësia e përdorimit të teknologjisë ka qenë dhe do mbetet shtylla kryesore e punës së ODK-së.

4. Albanian Institute of Science (AIS) / Çfarë bëjmë ne?

AIS është një organizatë shqiptare e themeluar në vitin 2011 dhe veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Organizata operon bazuar në 3 shtylla kryesore: Transparenca dhe Përgjegjësia përmes të Dhënave të Hapura (Open Data); Teknologjia në funksion të Qytetarëve; dhe Pjesëmarrja Qytetare. Organizata është mjaft e njohur për opinionin publik në Tiranë dhe luan një rol aktiv në fushën e transparencës. Puna dhe aktivitetet e organizatës përfshijnë programet që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve, trainimin dhe ndihmën për përfaqësuesit e shoqërisë civile, të rinjtë, gazetarët vendas dhe punonjësit e administratës shtetërore.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit nga të gjithë aktorët publik por dhe qytetarët, për të siguruar transparencë dhe përgjegjësi. Në vitet e fundit një nga objektivat kryesore të punës së AIS ka qenë të nxisë punësueshmërinë e të rinjëve duke siguruar një qasje të hapur për njohuri dhe aftësi kritike në sektorin TIK.

Gjithashtu, përdorimi i zgjidhjeve TIK në disa projekte të AIS ka prodhuar rezultate të mira për sa i përket transparencës, informacionit, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë. Projektet AIS kanë dhënë gjithashtu rezultate konkrete në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Projektet tërheqin interesat e mediave dhe janë të njohura për publikun në Shqipëri, si dhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Gazetarët, studentët dhe aktivistët e shoqërisë civile jo vetëm që kanë përfituar prej tij, por gjithashtu janë bërë pjesë e aktiviteteve që krijojnë në këtë mënyrë një formë të rrjetit të Pjesëmarrjes Elektronike (eParticipation). AIS organizoi Hackathon-in e parë në Shqipëri në vitin 2011, e ndjekur nga shumë Hackathons, Datathons dhe BootCamps ndër vite. Gjithashtu është organizator i dy DiploHack-ve të vetëm të mbajtur në Tiranë në 2016 dhe 2018.



5. Si të arrijmë bashkëpunime me institucionet arsimore në Kosovë dhe Shqipëri?

Ashtu edhe si u cek në pjesën më lart, ODK dhe AIS, veprojnë në fushën e transparencës me ndihmën e bashkëpunimit me institucionet publike në Kosovë dhe Shqipëri. Shoqëria civile ka një pozitë shumë specifike në sferën shtetërore, e kjo pozitë është edhe urë lidhëse mes qytetarëve dhe politikave të caktuara shtetërore.


Në mënyrë që një projekt i tillë të arrijë rezultatet e parashikuara përmes treguesve të përcaktuar, bashkëpunimi me institucione arsimore është obligim e jo preferencë. Prandaj, në të shumtën e rasteve të Projekteve të tilla, muajt në fillim të Projektit, ndahen për të pregaditur të gjitha dokumentet mbështetëse të cilat i jepin siguri më të madhe bashkëpunimeve të tilla.

Për Projektin në fjalë, janë nënshkruar gjithsej 4 Memorandume Bashkëpunimi, prej të cilave, një korrespondon për Shkollën Profesionale "Kolin Gjoka" në Lezhë, një për regjionin e Kurbinit (në kuadër të së cilit varen 4 shkolla të mesme në total), një për Universitetin "Ukshin

Hoti" në Prizren dhe një për Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Për të arritur në bashkëpunim përmes memorandumeve të tilla, të dy palët e pajtuara duhet të kenë të paktën një vizion të njejtë e të punojnë në frymë të ngjajshme. Prandaj, para se të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi, duhet fillimisht të dihet me saktësi fushëveprimi i palëve dhe interesi i përbashkët. Pasi që në kuadër të Projektit, flitet për një platformë e edukimit të hapur online, bashkëpunimi me institucione edukative/ arsimore ishte më se i nevojshëm.

Fillimisht, arritja e bashkëpunimit me Universitetin "Haxhi Zeka", ishte e lehtë dhe nuk duhet të bëhej përmes ndonjë organi tjetër të posacëm, por mund të realizohej me lehtësi drejtpërdrejt me Universitetin Haxhi Zeka. Duke qenë se Universiteti në fjalë është ekspozuar edhe më parë në Projekte të ndryshme të financuara nga BE, ata ishin shumë të hapur për bashkëpunim. Për më tepër, natyra e Projektit është unike



dhe shumë e nevojshme për institucionet edukative në Kosovë dhe Shqipëri, gjë që e bëri edhe më të lehtë realizimin e bashkëpunimit.

Fillimisht, para se të nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin "Haxhi Zeka", u caktua një takim ku u shpalos edhe ideja e projektit dhe përfitimet e Universitetit nëse pranojnë që studentët të marrin pjesë në këto kurse të hapura online. Pastaj, me pëlqimin e idesë dhe gadishmërinë për bashkëpunim, marrëveshja e bashkëpunimit u arrit.

E njehta procedurë vijoi edhe me Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, Universiteti i cili ishte poashtu ishte përfitues i bashkëpunimeve të ndryshme me Bashkimin Evropian.

Përsa i përket arritjes së Bashkëpunimit për Institucionet Arsimore në anën e Shqipërisë eksperiencia ka qënë e dyzuar. Për shkollën profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë e cila varet nga Ministria e Financave në Shqipëri, shkollë e cila ka dhe eksperiencia të mëparshme në projekte të ndryshme nga Eu apo dhe donatorë të tjerë, marrëveshja është firmosur menjëherë me drejtorin e shkollës z. Bardh Dedgjonaj si përfaqësues ligjor.

Ndërsa për katër gjimnazet e përgjithshme të bashkisë Kurbin që varen nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve me mbikëqyrje të Zyrës Arsimore Kurbin procesi ka qënë më i ndërlikuar dhe i zgjatur. Zyra Arsimore Kurbin dhe pse ka qënë shumë pozitive dhe e gatshme për të qënë pjesë e këtij bashkëpunimi i duhej ligjërisht të merrte një konfirmim nga Institucioni përgjegjës, në këtë rast Ministria e Arsimit.

Procesi i komunikimit me këtë Institucion ka qënë tepër formal, nëpërmjet rrugëve zyrtare (email dhe postë) dhe i tejzgjatur. Pas 6 muajsh komunikim të vazhdueshëm ndërmjet dy organizatave implementuese (AIS dhe ODK), Zyrës Arsimore Kurbin dhe Ministrisë u arrit të merret dhe konfirmimi për firmosjen e marrëveshjes me Drejtoreshën e Zyrës Arsimore znj. Majlinda Cara. Pavarisht zgjatjes se komunikimit për arritjen e firmosjes së marrëveshjes, gjatë kësaj periudhe u arrit të viheshin ura shumë të mira komunikimi dhe besimi me të dy këta Institucione, gjë që u vu në pah dhe me komunikimin tepër të shpejtë në periudhën e izolimit për shkak të Pandemisë Botërore të Covid- 19.

6. Kursori dhe Rrugëtimi i tij

Edukimi online është duke u bërë shpejt një fenomen i madh në mbarë botën, siç theksuam në një pjesë të "Kurse falas online". Këtu erdhi edhe idea për të krijuar platformën Kursori për të lehtësuar dhe ofruar komoditetin nxënësve dhe studentëve në veçanti atyre që kanë probleme me gjuhë dytësore.

Krahas kësaj Kursori është ndërtuar në platformën edX e cila është themeluar nga Harvard dhe MIT, ku edX është shtëpia e më shumë se 20 milion nxënësve dhe studentëve, ku shumica e universiteteve të rangut më të lartë në botë dhe ndërmarrjeve kryesore të industrisë kanë krijuar kurse të qasshme për të gjithë duke eliminuar barrierat e kostos, vendndodhjes dhe qasjes. Përbushja e kërkesës që njerëzit të mësojnë vetë me kushtet e tyre duke eliminuar barrierat e lartcekura.

Kurrikula e kurseve online është dizajnuar veçanërisht për të ndihmuar nxënësit dhe studentët në zhvillimin e aftësive të nevojshme në mënyrë që të përparojnë në karrierë dhe të shkëlqejnë në rrugëtimin profesional dhe akademik. Për më shumë kurrikula e kurseve online është e përshtatur të plotësojë mësimet e përfituara nga shkolla apo universiteti dhe të ju ndihmojë për një performancë të shkëlqyer.

Qëllimi fillestar i Kursorit ishte që të ofronte tre kurse në fushën e programimit të cilat do të mundësonin rritjen mundësinë për punësim në këtë fushë e cila është mjaft e kërkuar në tregun e punës. Kjo sepse parimisht, vendet e targetuara nga projekti nuk kanë ekonomi të zhvilluar, dhe pasi që kjo fushë ju mundëson edhe mundësi më të mëdha për punësim.

6.1. Hyrje në përmbajtjen e kurseve

Kurset janë të ndërtuara prej një formati ku pas çdo njësie mësimore janë kuizet dhe ushtrime praktike.

- Vështirësia dhe përmbajtja e ushtrimeve praktike ndërlidhet me njësinë që përdoruesi tashmë e ka ndjekur.

- Ushtrimet praktike ndihmojnë ndjekësit që në fund të kursit të jenë të gatshëm t'i përdorin njohuritë e reja të mësuara në ambientet shkollore dhe në punë.

→ Kursi #1 Zhvillimi Praktik i Web Aplikacioneve

Statistika: 79 video të ndara në 7 kapituj dhe 7 orë përmbajtje video.

Ky kurs është i dizajnuar të shpallë aftësitë bazike për kodim. Përmes këtij kursi ju mësoni planifikimin dhe zhvillimin e web aplikacioneve bazike, të cilat përfshijnë teknologjitë primare front-end si: HTML, CSS, Bootstrap, Javascript dhe jQuery.

→ Kursi #2: Dizajnimi, Analizimi dhe Integrimi i Bazës së të Dhënave në Web

Statistika: 75 video; 7 kapituj dhe 7 orë përmbajtje video.

Ky kurs shpallë temat kryesore të dizajnit, analizimit dhe integritit të bazës së të dhënave në web. Qëllimi është t'i ndihmojë nxënësve/studentëve dhe të gjithë të interesuarit të cilët nuk kanë njohuri paraprake në menaxhim të bazës së të dhënave, një temë shumë e kërkuar në tregun e tanishëm dhe të ardhshëm të punës.


– Kursi #3 Integrimi i Produkteve Softuerike të Përshkallëzuara

Statistika: 106 video (98 ligjerata + 8 kuize) të ndara në 8 kapituj dhe 7 orë përmbajtje video.

Ky kurs është krijuar me qëllim që të përgatisë të rinjtë në një nivel profesional, duke eksploruar konceptet, metodologjitë dhe mundësitë e përshkallëzimit dhe zgjerimit të arkitekturës së një sistemi. Në të njëjtën kohë nxënësit, studentët zhvillojnë aftësitë e dizajnit, konfigurimit dhe ndërtimit të një softueri të përshkallëzuar.

6.2. Ideja mbi animacionin

Animacioni ndjek idenë se shpikja e arsimit është pikë kthese në histori dhe ka bërë të mundur përshpejtimin e të gjitha arritjeve njerëzore. Duke shpikur konceptin e edukimit, njerëzit kanë krijuar kodin e evolucionit të teknologjisë. Përdorimi i kursorit si lëndë e animacionit forcon kuptimin e logos, e cila përmban edhe kursurin. Njëheritë është edhe elementi kryesor grafik që është përdorur në të gjitha materialet promovuese.



7. Programi i financuar nga BE-ja



Projekti “Edukim i Hapur TIK për punësimin e të Rinjve” është pjesë e programit ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë financuar nga Bashkimi Evropian, përmes Instrumentit të para antarësimit (IPA). Ky program ka për qëllim për të forcuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë përmes inkurajimit të bashkëpunimit midis njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve shtetërore.

Programet e IPA ndërkufitare kanë filluar qysh nga viti 2007, ato kanë synimin që të nxisin bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare dhe shteteve kandidate dhe gjithashtu midis kandidateve potencial në Bashkimin Evropian. Kështu, IPA është instrumenti i krijuar nga BE për të forcuar aftësinë institucionale duke u ofruar atyre ndihmë dhe ndihmë teknike në reformat administrative, politike, sociale dhe ekonomike.

Përmes programeve IPA Ndërkufitare në këtë rast mes Kosovës dhe Shqipërisë, ka bërë që kufiri të promovoj bashkëpunimin ndërmjet komunitetave në të dy anët e kufirit, dhe shndërrimin e kufirit në një mundësi për zhvillim dhe bashkëpunim. Kjo sidoms është shfrytëzuar duke marrë parasysh që nuk ka barriera gjuhësore dhe kulturore mes dy vendeve.

Open Data Kosovo dhe Instituti Kombëtar i Shkencave kanë qenë përfitues të fondeve të alokuara për vite 2014-2015 të IPA II, programit të programit ndërkufitar, si pjesë e Lot III - Integrimi Socio-Ekonomik i të rinjve. Ky prioritet kishte për qëllim që të bëhet një investim në rini dhe investim në arsim dhe aftësimin e tyre në tregun e punës.

Ky prioritet ishte identifikuar si rezultat të marra nga terreni i hapësirës që përfshinte pjesën ndërkufitare ku targetonte projekti me përqindjen e lartë të papunësisë tek të rinjtë si dhe përdorimin e teknologjisë si mjet për punësim duke marrë parasysh rritjen eksponenciale gjatë viteve të kaluara.

8. Rekomandimet nga përfituesit

"Ndërsa jeni duke menduar për aktivitete në kushte shtëpie, po sikur të mësonit kodimin? Platforma kursori.org është në dispozicion pa pagesë dhe ftoj të gjithë studentët dhe nxënësit të regjistrohen. Aty gjeni 3 kurse për zhvillimin e web aplikacioneve dhe integrimin e produkteve softwerike."

Besa Shahini, Ministre e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë



"Mundësia është privilegji më i madh që mund t'i ofrohet dikujt dhe ky privilegj ne na u siguroa nga kjo platformë. Përveç kësaj, ajo nxiti tek ne frymën e bashkëpunimit, që është themeli i kalase së suksesit!"

Jonida Paja nga Gjimnazi "Arif Halil Sulaj" në Mamurras.



"Kursori, mundësia më e mirë për t'u punësuar. Të mësuarit në një mënyrë shumë të mirë nga një staf i dedikuar. Është një derë e hapur për të gjithë dhe një ndihmë e mundësi për të ndërtuar të ardhmën."

Redjan Marku nga Gjimnazi "Arif Halil Sulaj" në Mamurras



Në programim kam qenë e interesuar qysh në moshë të re. Barriera e gjuhës dhe mungesa e një mentori më ka limituar në arritjen e qëllimeve të mija. Kjo platformë ka hapur dyert për mua në një gjë për të cilën shprehi interesim të madh.

Enxhi Legisi nga Gjimnazi "At Shtjefen Gjeçovi" në Laç



Platforma Kursori.org është më shumë se një kurs online për mua. Unë e shoh këtë platformë si dicka të re, një rrugë të re, një mundësi e re, që nuk do më mundësohej kurrë, një mënyrë për të arritur pritshmëritë e mija, një mënyrë për të plotësuar ëndërrat dhe për të zgjeruar pikëpamjet. Kursori është pikënisja e një rrugë që dua të ndjek. Dicka që më ka ndihmuar të bëhem ai që dua. Unë e shoh këtë platformë si një mundësi për dicka më të mirë, një hapje e dyerve, një mënyrë për të arritur qëllimet që kam në jetë.

Rubin Zefi nga Gjimnazi "At Shtjefen Kurti" në Gorre.



Open Data Kosovo më inkurajon të punoj shumë dhe të tregohem kreative. Diamanti është modifikim i karbonit. Në fillim, pa filluar të përdori Kursorin, unë isha si karboni, dhe tani me përdorimin e Kursorit, jam duke u modifikuar në diamant.

Ajshe Komoni nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.



Platforma Kursori.org është një ndihmesë e madhe për mua si nxënës në zhvillimin e aftësive që të përparoj në karrierë, por dhe të shkëlqej në rrugëtimin tim profesional. Leksionet e marra mund t'i praktikoj fare mirë në ndërtimin e faqeve web.

Stela Dedgjonaj nga Shkolla Profesionale "Kolin Gjoka" në Lezhë.



"Ndihem i lumtur që jam pjesë e Platformës kursori.org. E shikoj si një mundësi për zgjerimin e njohurive të mia, për të bërë realitet ëndërrën time të jem një programues në të ardhmën."

Ergi Syla nga Gjimnazi "Milot" në Milot



"Të punosh me ODK-në dhe të shfrytëzosh Platformën Kursori është një privilegj i madh. Këto të fundit inkurajojnë vajzat e reja të kodojnë dhe të shprehen në një shoqëri ku vajzat shihen si jo të gatshme."

Fatima Elezi nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren



"Platforma Kursori na ka dhënë mundësi të rrallë të mësojmë, t'i zhvillojmë idetë tona dhe të kemi një të ardhme të sigurtë përmes zhvillimit të teknologjisë në vendin tonë!"

Fatjona Shala nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren



Financuar nga:



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Zbatuar nga



ALBANIAN INSTITUTE
of SCIENCE 

Ky publikim u realizua me ndihmën financiare nga Bashkimi Evropian. Përbajtja është përgjegjësi ekskluzive e Open Data Kosovo* dhe Institutit Shqiptar të Shkencave dhe nuk reflektonjë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

*Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS-OKB dhe Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.